

LIGJ
Nr. 60/2022

PËR SHPALLJEN E MORATORIUMIT TË GJUE TISË NË REPUBLIKËN E
SHQIPËRISË

(Ndryshuar me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

(I përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i këtij ligji është ndalimi i ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë, me qëllim përmirësimin e gjendjes së llojeve të faunës së egër, objekt gjuetie.

Neni 2

Objekti dhe fusha e veprimit

Ky ligj përcakton rregullat që do të zbatohen gjatë ndalimit të ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 3

**Pezullimi i përdorimit të zonave të gjuetisë dhe pezullimi i gjuetisë në zonat e
mbarështimit të faunës së egër**

1. Përdorimi i zonave të gjuetisë, të dhëna për këtë qëllim nëpërmjet ofertës publike sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë, pezullohet.

2. Kontratat për mbarështimin e faunës së egër janë të vlefshme, por edhe në këto zona ku mbarështohet fauna e egër nuk mund të ushtrohet gjuetia deri në afatën e zbatimit të këtij ligji.

Neni 4

Përfshirja nga fusha e veprimit

1. Përfshihen nga fusha e zbatimit të nenit 2 të këtij ligji:

- a) gjuetia në rastet e konstatimit të mbipopullimit të një lloji të faunës së egër në zonat e lejuara për gjueti dhe në rezervatet e mbarështimit, si dhe në rastet e konstatimit të dëmtimit të kulturave bujqësore, blegtorisë dhe ndaj jetës njerëzore në zonat rurale sipas legjislacionit në fuqi për gjuetinë;
- b) gjuetia për qëllime kërkimore-shkencore.

2. Rastet përjashtimore të përcaktuara në pikën 1 të këtij neni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës për mjedisin.

Neni 5

Afati i zbatimit

Afati i zbatimit të këtij ligji është tre vjet nga data e hyrjes së tij në fuqi.

Neni 6

Organet e kontrollit

(Ndryshuar shkronja "a", hequr togfjalësh në shkronjën "b" të pikës 1 dhe shtuar togfjalësh në pikën 4 me ligjin nr. 99/2024, datë 12.9.2024)

1. Organet që kontrollojnë zbatimin e rregullave për ndalimin e ushtrimit të veprimtarisë së gjuetisë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:
 - a) strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese brenda fushës së përgjegjësisë;
 - b) Ministria e Brendshme nëpërmjet Policisë së Shtetit;
 - c) strukturat përgjegjëse kontrolluese/inspektuese në bashki.
2. Veprimtaria kontrolluese, sipas këtij neni, ushtrohet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.
3. Të drejtën e vendosjes së gjobës e kanë strukturat që janë përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.
4. Shqyrtimi e marrja e vendimit përfundimtar dhe ankimi ndaj tij bëhet në përputhje me ligjin për inspektimin nga struktura përgjegjëse për inspektimin në përputhje me Kodin e Procedurave Administrative, si dhe me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

Neni 7

Sanksionet

1. Shkeljet e këtij ligji, kur nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen si më poshtë:
 - a) kur shkelja kryhet e organizuar nga operatorët e tureve të gjuetisë, shoqatat e gjuetarëve ose federatat e gjuetarëve, subjekti që e organizon dënohet me gjobë në masën 800 000 (tetëqind mijë) deri në 1 000 000 (një milion) lekë;
 - b) kur shkelja kryhet nga një person ose personi është pjesëtar i subjekteve organizuese sipas shkronjës "a" të kësaj pike, personi dënohet me gjobë në masën 80 000 (tetëdhjetë mijë) deri në 100 000 (njëqind mijë) lekë.
2. Në rastet e përsëritjes së shkeljes nga subjektet e parashikuara në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 1 të këtij neni, përveç dënimit me gjobë, vendoset si dënim plotësues edhe heqja e lejes së gjuetisë, si dhe konfiskimi i armës së gjahut.

Neni 8

Aktet nënligjore

Ngarkohet Këshilli i Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore rast pas rasti në zbatim të pikës 2 të nenit 4 të këtij ligji.

Neni 9

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miratuar më datë 21.7.2022.

Shpallur me dekretin nr. 13844, datë 5.8.2022, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.